

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM T3 - 2021

*Erjona Suljoti, Medvin Shehu, Anjeza Gazidede dhe Sofika Note
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

TETOR 2021

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk
pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

P Ë R M B A J T J A

<i>HYRJE</i>	<i>4</i>
<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>5</i>
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	<i>6</i>
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	<i>9</i>
<i>3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	<i>12</i>

HYRJE

Ky material synon të japë një panoramë të prirjes së aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, në të analizohen të dhënat monetare, si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në disa nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në material janë: a) të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin privat të ekonomisë; b) të dhënat cilësore të marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues (VAK); c) statistikave për normat e interesit të kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro; d) të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Rumania (RO), Serbia (SR), Polonia (PL), Hungaria (HU), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Të dhënat e kredisë merren nga bilancet e bankave dhe i referohen financimit të bankave vendase për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Analiza e portofolit të kredisë bazohet në të dhënat e kredisë të rregulluara për efektin e kursit të këmbimit dhe për kreditë e fshira nga bilanci, proces të cilin bankat e kanë ndërmarrë bazuar në vendimin nr. 50, datë 30.3.2015, "Për ndryshimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë".

Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 22 tetor 2021, të cilat përshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend, deri në muajin shtator 2021, dhe të dhënat e Vrojtimin të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2021. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin gusht 2021.

PËRMBLEDHJE


Kredia për sektorin privat ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes në tremujorin e tretë të vitit 2021, duke reflektuar:

- **Përmirësimin e kredisë për biznese**, i cili vihet re në të gjitha kategoritë, si për sa i përket madhësisë së biznesit ashtu edhe sektorit të ekonomisë. Në linjë me zhvillimet ekonomike, biznesi i madh vijon të jetë përfituesi kryesor i financimit të bankave. Ndërkohë, përmirësim të dukshëm kanë treguar bizneset e sektorit të ndërtimit dhe ato të tregtisë, hoteleve dhe restoranteve.
- **Ritmet më të larta të rritjes së kredisë për individë**, të mbështetura si nga kredia për konsum ashtu edhe nga ajo për blerje banese. Rigjallërimi i konsumit ka nxitur kërkesën më të lartë për financim të individëve.
- **Lehtësimin e kushteve të kreditimit nga bankat**, si për bizneset ashtu edhe për individët në tremujorin e tretë të vitit. Kjo ecuri vjen në reflektim të përmirësimit të situatës makro, të reduktimit të primeve të rrezikut, si edhe të një përjasjeje më pozitive ndaj kreditimit.
- **Qëndrueshmërinë e normave të interesit** për kreditë e reja në lekë këtë tremujor, me ulje marginale në segmente të caktuara, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Në përgjithësi, interesat e kredive kanë vijuar të luhaten në nivele të ulëta, duke konfirmuar kushte të përgjithshme favorizuese për investimet dhe konsumin.
- **Një ecuri më të mirë të kredisë për sektorin privat në vendet e rajonit** krahasuar me gjysmën e parë të vitit. Kredia për individë ka shënuar norma më të larta rritjeje në pjesën më të madhe të vendeve. E njëjta tablo paraqitet edhe në kredinë për biznese në vendet e Ballkanit, ndërkohë që ajo është tkurrur disi më pak në vendet e Evropës Qendrore.

1. KREDIA PËR BIZNESE

Kredia për biznese ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes, e vërejtur në të gjitha kategoritë. Megjithatë, rritja në tremujorin e tretë ka qenë më e dukshme tek kredia për biznesin e madh dhe për sektorët e tregtisë, hotelierisë dhe restoranteve, si dhe ndërtimit.

Përmirësimi i shpejtë i aktivitetit ekonomik në vend dhe përfaqja më pozitive e bankave ndaj kreditimit kanë ndihmuar në përmirësimin e ritmeve të rritjes së kredisë për biznese në 8%, në tremujorin e tretë. Kjo rritje është mbështetur nga normat më të larta të rritjes si të kredisë për biznesin e madh ashtu edhe atij të vogël, të cilat shënuan përkatësisht 6.3% dhe 8.9%. Zgjerimi i kredisë për biznesin e vogël e të mesëm ka qenë kryesisht në lekë, duke ndryshuar pak tendencën e vërejtur në tremujorët e fundit. E kundërta ka ndodhur për kredinë e biznesit të madh, e cila në këtë tremujor ka njohur rritje në kredinë në valutë. Në fund të tremujorit, kredia për biznesin e madh përbënte 52% të tepricës së kredisë për biznese, lehtësisht më lart se në fund të vitit 2019.




Përmirësimi i normave të rritjes së kredisë për biznese shfaqet tek të gjithë sektorët e ekonomisë, por në veçanti ai është ndikuar nga financimi i bizneseve në sektorin e ndërtimit dhe të tregtisë, hotelierisë dhe restoranteve. Kredia për këta sektorë shënoi përmirësim të fortë të ritmeve të rritjes në përkatësisht 13.2% dhe 11.8%. Për sektorin e ndërtimit dhe tregtisë, kjo kredi u përdor kryesisht për mbulimin e nevojave për likuiditet, ndërsa për sektorin e hotelierisë dhe restoranteve, kredia është nxitur kryesisht nga nevoja për financimin e investimeve. Këto zhvillime janë në linjë me rigjallërimin e aktivitetit ekonomik në vend, forcimin e besimit si dhe pritjet pozitive për të ardhmen. Në fund të muajit shtator, pesha e kredisë për këta sektorë ndaj totalit është rritur lehtësisht, duke shkuar në 61% të portofolit të kredisë për biznese. Kredia për sektorin e


buqësisë dhe të industrisë ka shfaqur rritje të moderuar. Pesha e kredisë për buqësinë mbeti e pandryshuar nga ajo e fundvitit 2020, në 1.6%, ndërsa ajo për industrinë u ul lehtësisht në 25% ndaj totalit të kredisë për biznese.

Normat e interesit të kredive në lekë për bizneset nuk kanë ndryshuar shumë në tremujorin e tretë të vitit, duke reflektuar një përfaqje pozitive të bankave ndaj financimit të sektorit privat. Kushtet e pandryshuara monetare edhe një ambient i qetë financiar kanë favorizuar bankat në këtë drejtim. Ecuri të njëjtë kanë treguar edhe interesat për kreditë në euro, të cilat kanë regjistruar vlera të ngjashme me tremujorët e mëparshëm.

Në tremujorin e tretë të vitit, normat e interesit të kredisë për biznese kanë qëndruar në nivele të afërta me tremujorin e dytë. Norma mesatare e interesit për këtë segment rezultoi 5.6%, nga 5.4% dhe 5.8% që ishte përkatësisht në dy tremujorët paraardhës. Përtej luhatjeve mujore, interesat e aplikuar nga bankat evidentojnë prime të përmbajtura rreziku, duke mbështetur momentin pozitiv të ekonomisë. Analiza sipas segmenteve tregon një zvogëlim të interesave tek segmenti i kredive deri në 35 milionë lekë. Norma mesatare e interesit për këto kredi rezultoi 5.6% në tremujorin e tretë, nga 5.8% dhe 6.2% që ishte në dy tremujorët paraardhës. Ky segment përfaqëson kryesisht bizneset e vogla dhe të mesme dhe përafron përfaqjen e përgjithshme pozitive të bankave në kreditim. Ndërkohë, interesi mesatar për kreditë në segmentin mbi 35 milionë lekë ka regjistruar rritje këtë tremujor, duke rezultuar 5.5% nga 5.2% që ishte një tremujor më parë. Kjo rritje ka reflektuar vlerat veçanërisht të larta të muajit shtator për kreditë 35 - 140 milionë lekë, si edhe nivelin e interesave për kreditë mbi 140 milionë lekë në muajin korrik. Normat e interesit në këtë segment gjithsesi karakterizohen nga luhatshmëri e lartë.



Analiza sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit¹ tregon një rritje të lehtë të normës afatshkurtër të interesit këtë tremujor krahasuar me tremujorin e dytë. Gjithsesi interesi i kësaj kategorie (5.5%) mbetet i njëjtë me mesataren e gjysmës së parë të këtij viti si edhe më poshtë se ajo e vitit të kaluar (5.7%)². Norma e interesit e kategorisë që përaftron periudhën afatmesme apo afatgjatë regjistroi ulje këtë tremujor, duke rezultuar 5.5% nga 5.8% që ishte në pjesën e parë të vitit. Ecuria e interesave tek të dyja këto kategori tregon për prime rreziku në kahun rënës edhe pritje inflacioniste të përmbajtura nga ana e bankave.




Norma e interesit për kreditë në euro për bizneset është shfaqur e qëndrueshme në tremujorin e tretë të vitit. Ajo rezultoi 4.4%, duke qenë lehtas më poshtë se tremujori i dytë (4.5%) dhe e njëjtë me pjesën e parë të vitit. Sipas madhësisë së kredisë, interesat kanë shënuar ulje minimale tek kreditë e vogla edhe tek kreditë e mëdha (mbi 1 mln euro), ndërkohë që segmenti i mesëm nuk ka ndryshuar. Analiza sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit tregon se interesi i kredive me normë interesi të fiksuar deri në një vit ka shfaqur rritje të lehtë gjatë këtij viti (4.7% në këtë tremujor nga 4.4% në fillimin e vitit). E kundërta ka ndodhur me kreditë me normë të fiksuar mbi një vit.

Kushtet jo-çmim janë lehtësuar disi për bizneset, duke konfirmuar një përfaqje më pozitive të bankave ndaj financimit të tyre.

¹ Periudha e fiksimit nënkupton periudhën për të cilën norma e interesit të kredisë është fikse dhe nuk ndryshon. Një kredi mund të jepet: a) me normë interesi të ndryshueshme, b) për disa periudha fikse dhe më pas e ndryshueshme, ose c) fikse, përgjatë gjithë afatit të maturimit të saj. Për qëllim të kësaj analize, norma e interesit për kreditë e dhëna me normë të ndryshueshme dhe për ato me normë fikse deri në një vit është quajtur normë afatshkurtër; ajo për kreditë e dhëna me normë fikse mbi një vit dhe deri në 5 vjet është quajtur normë afatmesme; ajo për kreditë e dhëna me normë fikse mbi 5 vjet është quajtur normë afatgjatë. Në këtë mënyrë, koncepti afatshkurtër/afatgjatë lidhet me kohën në të cilën norma e interesit të kredisë është e pandryshuar apo fikse, dhe jo me maturitetin e kredisë.

² Intervali prilldhjetor që përkon me normën bazë në nivelin 0.50%.

Grafik 4. Kushtet joçmim për kreditë e reja të bizneseve




Përmirësimi i situatës makroekonomike, si edhe perceptimi për perspektivën e ekonomisë i ka bërë bankat të shfaqin tolerancë më të lartë në procesin e miratimit të aplikimeve për kredi nga bizneset. Toleranca më e lartë e bankave në aprovimin e kredive të reja, krahas standardeve më të lehtësuara, u shpreh dhe në numër më të lartë aprovimesh në raport me totalin e kërkesave për kredi nga ana e bizneseve. Elementi i tretë që ilustron kushtet e ofertës për kredi, - kushtet e termat e kreditimit - u raportua i pandryshuar nga një tremujor më parë. Kërkesën e shtuar për kredi në këtë tremujor, sidomos nga biznesi i madh, bankat e kanë akomoduar pa i ndryshuar në thelb kushtet joçmim. Shtimi i madhësisë së kredisë për bizneset është kundërbalancuar nga kushtëzime më të larta në marrëveshjet e kredive nënshkruar mes palëve. Kushtet e tjera joçmim – komisionet, kërkesat për kolateral, si edhe maturiteti i kredisë – nuk ndryshuan nga një tremujor më parë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

Bankat kanë rritur financimin për individët, në të dyja kategoritë kryesore të tij. Përmirësimi i situatës së përgjithshme makroekonomike, forcimi i besimit edhe pritjet pozitive për të ardhmen kanë mbështetur si kërkesën, ashtu edhe ofertën e kredisë për individë.

Krahas rritjes së financimit për biznese, bankat kanë rritur financimin edhe për individët, të cilët kanë përfituar nga kushtet favorizuese të kreditimit dhe nga përfaqja pozitive e bankave në kreditim. Kredia për individë ruajti norma të larta rritjeje prej 10.7% gjatë tremujorit të tretë, duke vijuar trajektoren pozitive të nisur nga fillimi i këtij viti. Përshpejtim i normave të rritjes vihet re në të gjitha nënkategoritë përbërëse të këtij portofoli dhe ka ndikuar në rritjen e peshës së tij në 35% ndaj kredisë për sektorin privat.

Kredia konsumatore shfaqti përshpejtim të normës vjetore të rritjes në 8.2% gjatë tremujorit të tretë, duke qëndruar 2.3 pp më lart se në tremujorin e kaluar. Zgjerimi i kredisë konsumatore ka reflektuar rritjen e kredisë për overdraft dhe për blerjen e mallrave të paqëndrueshme dhe rritjen e kredisë për blerjen e mallrave të qëndrueshme. Në muajin shtator 2021, kredia për konsum zë rreth 29.1% të portofolit të kredisë për individë, duke u ulur me 2 pp krahasuar me të njëjtën periudhë.




Portofoli i kredisë për banesa është rritur me rreth 13% gjatë tremujorit të tretë, duke vijuar trajektoren rritëse të vërejtur prej më shumë se një viti tashmë. Kjo ecuri ka çuar në rritjen e peshës së këtij portofoli në kredinë për individë në 65%, nga 62% një vit më parë. Rritja e kredisë për banesa reflekton nga njëra anë kërkesën e shtuar të individëve dhe, nga ana tjetër, kushtet e favorshme të kreditimit – si ato çmim ashtu edhe ato jo-çmim – të aplikuara nga bankat për këtë kategori kredie. Ngushtimi i vazhdueshëm i diferencialis të normave të interesit lek-euro, së bashku me politikat nxitëse të bankave për të kredituar individët në monedhën që ato kanë të ardhura, ka ndihmuar në një kontribut të lartë të kredisë në lekë ndaj totalit të kredisë për banesa. Kredia në lekë ka dominuar zgjerimin e portofolit në pesë vitet e fundit.


Individët kanë përfituar financim me norma më të ulëta interesi për kreditë hipotekare në lekë, ndërkohë që normat e interesit për kreditë konsumatore janë shfaqur të qëndrueshme për të dyja monedhat.

Norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare në lekë për individët regjistroi një ulje të mëtejshme në tremujorin e tretë të vitit, duke shënuar 3.2% nga 3.5% që ishte një tremujor më parë. Duke filluar prej muajit prill, kjo normë luhet poshtë 4.0% dhe në muajin gusht ajo zbriti në 2.8%. Vlen të theksohet që ulja e interesave të kësaj kategorie këtë tremujor ka qenë e pranishme si tek kreditë me normë të fiksuar deri në 1 vit, ashtu edhe tek ato me interesa të fiksuara deri 5- ose 10-vjet. Këto të fundit tregojnë për perceptim për rrezik të ulët të kredisë. Po ashtu, nivelet e ulëta dhe të qëndrueshme të interesave për kredinë konsumatore tregojnë për një ambient financiar të qetë edhe mbështetës për

kërkesën e individëve. Interesi i kësaj kategorie rezultoi 8.3% në këtë tremujor, duke qëndruar pranë nivelit të një tremujori më parë dhe mesatares së vitit 2020³.



Norma mesatare e kredive në euro për individë shënoi një rritje të lehtë në tremujorin e tretë të vitit (3.6% nga 3.4% e gjysmës së parë të 2021), duke qëndruar gjithsesi poshtë niveleve të vitit 2020 (4.1%). Interesat këtë tremujor u rritën lehtas si për kredinë hipotekare⁴ ashtu edhe për financim konsumi. Brenda kategorisë së kredisë për banesa, interesi i kredisë me normë të fiksuar deri një vit njohu rritje. Ndërkohë, kredia me normë të fiksuar interesi mbi një vit rezultoi me vlera të pandryshuara nga tremujorët e fundit (3.4%). Diferenca mes interesit të kredisë hipotekare në lekë dhe asaj në euro vijon të jetë minimale gjatë këtij tremujori.




³ Në llogaritjen e mesatares për këtë vit përjashtohet muaji prill, kur norma e interesit për kredinë konsumatore ishte ndjeshëm e ulët, ndikuar nga kreditë e një banke të sistemit.

⁴ Kredia hipotekare dominon ndjeshëm kredinë në euro për individë, për këtë arsye analiza është përqendruar vetëm në këtë segment.

Kushtet e termat e kreditimit të kredive të reja akorduar individëve u lehtësuan më tej.

Lehtësimi i kushteve e termave të kreditimit për individët, krahas politikave më të lehtësuara në miratimin e kredive, vijoi edhe në tremujorin e tretë. Nxitur nga situata aktuale ekonomike, pritjet për aftësinë paguese të klientëve të tyre, si edhe dhe nga konkurrenca e shtuar në sistemin bankar, bankat preferuan të lehtësonin më tej elementet jo-çmim në miratimin e kredive, sidomos në segmentin e kredive hipotekare. Krahas miratimit të një numri më të lartë aplikimesh për kredi të individëve, bankat iu ofruan atyre kushte më të favorshme kreditimi, duke përcaktuar kërkesa më të ulëta për kolateral në raport me kredinë e aprovuar, si edhe duke iu zgjatur individëve maturitetin maksimal të kredisë.




3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT⁵

Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit ka shfaqur një ecuri më të mirë në muajt korrik dhe gusht në krahasim me gjysmën e parë të vitit. Kredia për individë ka shënuar norma të larta rritjeje në pjesën më të madhe të vendeve. Nga ana tjetër, kredia për biznese në vendet e Ballkanit është rritur, ndërsa në vendet e Evropës Qendrore ka vijuar të tkurret, por me norma më të ulëta.

Zhvillimet në kredinë për sektorin privat në vendet e rajonit të EQJL-së gjatë muajve korrik dhe gusht kanë qenë pozitive, pas një gjashtëmujori të parë të plogësht. Rritja vjetore e saj shënoi mesatarisht 1.6% në këta dy muaj, pas rritjes minimale prej 0.2% në gjysmën e parë të vitit. Përmirësimi reflekton përshejtimin e rritjes së kredisë në vendet e Ballkanit dhe tendencën rikuperuese të kredisë në vendet e Evropës Qendrore. Krahas masave mbështetëse të ndërmarra

⁵ Në këtë analizë përfshihen 9 vende të rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Çeki, Poloni dhe Hungari. Stoku i kredisë për sektorin privat është i rregulluar për efektin e inflacionit dhe kursit të këmbimit.

nga autoritetet monetare dhe mbikëqyrëse, financimi për sektorin privat është ndihmuar edhe nga politikat e grupeve ndërkombëtare me prezencë në rajon. Këto të fundit synojnë të ruajnë pozicionin aktual që kanë në këto tregje ose të zgjerohen më tej⁶.




Kredia për biznese në rajon vazhdon të shfaqë ecuri të ndryshme në vendet e Ballkanit dhe ato të Evropës Qendrore. Në grupin e këtyre të fundit, kredia për biznese vijon të tkurret, duke reflektuar rënien e portofolit në Poloni e në Çeki⁷. Megjithatë, tkurrja e saj është zvogëluar ndjeshëm gjatë muajve korrik dhe gusht, duke shënuar 2.6%, nga 5.4% që shënonte mesatarisht në tremujorin e dytë të vitit. Ndryshe nga vendet e sipërpërmendura, Hungaria paraqet një moment pozitiv sa i takon ecurisë së kredisë për biznese. Në vendet e Ballkanit, kredia për biznese ka vazhduar të rritet me norma gjithnjë e më të larta. Rritja vjetore shënoi mesatarisht 5.0% në muajt korrik dhe gusht, ose rreth 1.0 pp më lart se në tremujorin e dytë të vitit. Tek vendet me performancën më të mirë renditen Rumania dhe Shqipëria.

Sipas vërtimit të aktivitetit kreditues për vendet e rajonit, kërkesa për kredi nga ana e bizneseve ka reflektuar si rritjen e kërkesës për financim të investimeve, ashtu edhe rritjen e vazhduar të kërkesës për kapital qarkullues. Rritje të kërkesës vlerësohet të kenë shfaqur si bizneset e mëdha, ashtu edhe ato të mesme e të vogla.

⁶ Sikurse raportohet në VAK-un në vendet e EQJL-së. Për më shumë detaje, mund t'i referoheni adresës së mëposhtme: <https://www.eib.org/en/publications/cesee-bls-2021-h1>

⁷ Tkurrja e portofolit të biznesit në disa prej këtyre vendeve lidhet ndër të tjera me masat e ndërmarra nga qeveritë në kuadër të pandemisë, ku paketat ndihmëse janë konceptuar në formën e pagesave të drejtpërdrejta ndaj bizneseve, duke ulur kërkesën e tyre për kredi.


Grafik 10. Kredia për bizneset në rajonin e EQJL-së



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; BEI - Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në vendet e EQJL-së; llogaritje të stafit.

Kredia për individë është shfaqur e përmirësuar në muajt korrik dhe gusht, në të gjitha vendet e marra në analizë. Ajo shënoi një rritje mesatare vjetore prej 3.0% gjatë këtyre dy muajve, nga 2.3% që ishte në tremujorin e dytë të vitit. Zgjerimi i kredisë për individë udhëhiqet nga vendet e Ballkanit, por ajo ka ardhur në përmirësim edhe në vendet e Evropës Qendrore gjatë muajve të fundit. Kërkesa për kredi nga individët vlerësohet e rritur, si për kredi hipotekare, ashtu edhe kredi konsumatore, e nxitur nga përmirësimi i besimit konsumator.

Grafik 11. Kredia për individët në rajonin e EQJL-së.



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; BEI - Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në vendet e EQJL-së; llogaritje të stafit.